

Tiranë, më 10 Gusht 2022

KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI

SUBJEKT TREGTAR/KOMPANI QË OFRON PRODHIMIN E NJË VIDEO INFORMUESE DHE NDËRGJEGJËSUESE MBI ROLIN E KUVENDIT DHE RËNDËSINË E ANGAZHIMIT TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË MEKANIZMAT E VËNIES NË LËVIZJE TË KUVENDIT

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në kuadër të implementimit të grantit të akorduar në zbatim të projektit “Për mbështetjen e Kuvendit dhe Edukimit Qytetar (PACEP)”, projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e zbatuar nga Prezenca e OSBE në Shqipëri dhe Instituti Demokratik Amerikan (NDI), shpall thirrjen për subjekt tregtar/individ që ofron shërbimin e prodhimit të një video informuese dhe ndërgjegjësuere mbi rolin e Kuvendit dhe rëndësinë e angazhimit të organizatave të shoqërisë civile në mekanizmat e vënies në lëvizje të Kuvendit.

Qëllimi i kësaj video, e cila do të shpërndahet në një ose disa televizione kombëtare apo lokale, dhe/ose në billboard-e në qytetin e Tiranës, si dhe në rrjetet sociale të organizatës, është të përcjellë mesazhe ndërgjegjësuere rreth mënyrës së përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile, por edhe qytetarëve në procese vendimmarrëse në Kuvend, si dhe të promovojë iniciativat ligjvënëse në të cilat Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka qënë i përfshirë në kuadër të zbatimit të këtij projekti.

Video duhet të përfshijë:

- Intervista/mesazhe të shkurtra promovuese
- Personazhet e përfshirë në video do t'i përkasin moshave, profesioneve dhe grupeve të ndryshme të shoqërisë
- Vendndodhjet e filmimeve të videos promovuese do të jenë pika kyçe të kryeqytetit
- Elementë tingulli (sfond).
- Skenari si dhe vendndodhja e filmimeve do të realizohet/vendoset në bashkëpunim me përfaqësues nga KShH, zbatues të projektit;
- Video mund të jetë rreth 4-5 minuta e gjatë (në varësi të filmimeve/materialit që do të prodhohet).

KShH inkurajon subjektet tregatere/individët e interesuar që të dërgojnë në formë elektronike në adresën e e-mailit të KShH-së office@ahc.org.al, deri në datën 19 Gusht 2022, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Ofertën Financiare (në lekë me TVSH)
2. CV;
3. Certifikate regjistrimi (në rastin e subjektit tregtar/kompanisë);
4. Listë me punime të realizuara më pare dhe links për aksesimin e tyre.

Vetëm subjekti i përzgjedhur do të njoftohet me anë të e-mailit për të vijuar me lidhjen e kontratës dhe prodhimin e videos.

Me konsideratë,

Komiteti Shqiptar i Helsinkit